

ENTI RREGULLATOR I UJIT



SHOQËRIA RAJONALE UK GJIROKASTËR

ANALIZA E HUMBJEVE TË UJIT PËR VITIN 2022

Tiranë, 2023

Bilanci i Ujit

Analiza e Humbjeve të Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Gjirokastrë

I. Të Përgjithshme mbi Hartimin e Bilancit të Ujit

ERRU harton çdo vit Raportin e Bilancit të Ujit për shoqëritë që operojnë në Sektorin Ujësjellës - Kanalizime. Ky raport merr një rëndësi të veçantë për një menaxhim racional të sektorit sepse trajton në mënyrë të veçantë treguesin e Ujit Pa të Ardhura, pra humbjet e ujit. Treguesi UPA lidhet ngushtësisht më cilësinë e shërbimeve që shoqëritë i ofrojnë konsumatorëve si edhe më qëndrueshmërinë financiare të tyre.

Organizimi i ri i shoqërive, në 15 shoqëri rajonale në sektorin UK, ka sjellë nevojën për një strukturim të ri të analizës mbi UPA dhe “Bilancin e Ujit” në tërësi. Analiza e humbjeve të ujit për çdo shoqëri rajonale kryhet duke analizuar fillimisht Bilancin e Ujit më vetë për çdo njësi (ish shoqëri UK) që tashmë është nën administrimin e shoqërisë rajonale të krijuar dhe më pas analiza ëhet në mënyrë të integruar për shoqërinë rajonale në tërësi. Kjo qasje mundëson vënien në pah të problematikave individuale të çdo njësie të cilat duhet të kihen parasysh në të ardhmen për zgjidhjen apo përmirësimin e tyre.

Kjo analizë i vjen në ndihmë çdo shoqërie rajonale duke i mundësuar asaj që nëpërmjet analizës së komponentëve përbërës të Bilancit të Ujit, për çdo njësi dhe në tërësinë e shoqërisë rajonale, të njihet në mënyrë analitike më nivelin e humbjeve (UPA), të nën komponentëve të saj, arsyet e veçanta të nivelit të lartë të humbjeve të ujit, nevojën dhe mënyrën e monitorimit të humbjeve, problematikave e faturimit më matje dhe aforfe, si dhe rekomandimet që ERRU jep për çdo shoqëri UK për të realizuar përmirësimet e nevojshme në punën e tyre.

“Bilanci i Ujit” si një instrument mjaft i rëndësishëm në përmirësimin e treguesit kryesor të performancës UPA, duhet të hartohet më të dhëna sa më të sakta pasi hapat që do të ndërmerren për reduktimin e tij lidhen ngushtësisht edhe më qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë.

Si model i hartimit të Bilancit të Ujit do të përdoret ai i IWA (Shoqërisë Ndërkombëtare të Shoqërive të Ujësjellësve).

Duke patur parasysh gjendjen teknike të sistemeve të furnizimit më ujë si mungesën e matësve në burim, mos organizim të rrjeteve shpërndarëse bazuar në konceptin e Zonave më Matje të Pavarura (DMA-të), mangësitë në mjetet dhe metodat e monitorimit të konsumit, është vendosur që si metodologji e llogaritjes së nën komponentëve të Bilancit të Ujit të përdoret ajo nga “lart-poshtë” (top-down), ku fokusi kryesor në llogaritjen e humbjeve totale është përcaktimi i humbjeve të dukshme, dhe më tej përcaktohen ato reale.

II. Analiza e “Uji Pa të Ardhura” (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Gjirokastrë

Shoqëria rajonale UK Gjirokastrë u krijua nga bashkimi i ish shoqërive UK ose Njësitë, përkatësisht UK Gjirokastrë, Tepelenë, Këlcyrë, Përmet, Libohovë, Dropull dhe Memaliaj.

Të dhëna të përgjithshme në lidhje më popullsinë e shërbyer, konsumin për banorë më matje dhe pa matje në të gjithë zonën e shërbimit të Sh. R UK Gjirokastrë jepen në **tabelën 1**.

Nga të dhënat e Tabelës 1, probleme të **nën faturimit** me matje nuk konstatohen në asnjë prej ish shoqërive që përbëjnë Sh. R Gjirokastrë. Probleme me **faturimin aforfe** rezultuan në të gjitha njësitë e Sh. R Gjirokastrë.

Njësitë Memaliaj, Tepelenë dhe Përmet të cilat duhet të analizojnë arsyet e nën faturimit aforfe (nëse përfshijnë në të dhe klientët jo aktive), sepse dihet që konsumi mesatar për banorë për këtë lloj faturimi

referuar VKM nr.102, datë 16.03.1992 duhet të jetë 150 litra/ ditë për banorë. Referuar po këtij vendimi, ish shoqëritë UK Gjirokastrë (412.2 litra/ ditë për banorë), Këlcyrë (280.1 litra/ ditë për banorë), Libohovë (235.1 litra/ ditë/ banorë) dhe Dropull (243.8 litra/ ditë për banorë) duhet të analizojnë me kujdes të dhënat mbi volumet e faturuara dhe numrin e klientëve të faturuar aforfe, për të gjetur dhe arsyet e këtij mbi faturimi.

Tabela Nr. 1 Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare më Matje dhe Aforfe

Sh. Rajonale Gjirokastrë	Popullsia* e Shërbyer	konsumi total (në m3)	Konsumi i matur (në m3)	Konsumi i pamatur (në m3)	Nr. lidhjeve me matës	Nr. lidhjeve pa matës	Konsumi matur	Konsumi aforfe	Konsumi Total
							(l/ditë, banor)		
Gjirokastrë	19,560	1,419,000	776,000	643,000	9,531	2,665	139.1	412.2	198.8
Tepelenë	4,623	231,000	159,000	72,000	1,593	939	149.8	115.1	136.9
Këlcyrë	1,781	171,000	163,000	8,000	1,545	71	262.3	280.1	263.1
Përmet	6,858	421,900	398,400	23,500	3,967	335	172.6	120.6	168.5
Libohove	3,542	304,000	0	304,000	0	1,499	0.0	235.1	235.1
Dropull	8,023	714,000	0	714,000	0	4,438	0.0	243.8	243.8
Memaliaj	2,564	143,000	120,000	23,000	1,345	517	177.5	88.5	152.8
Shuma	46,951	3,403,900	1,616,400	1,787,500	17,981	10,464	149.2	283.5	198.6

Nga ana tjetër referuar tendencës së rritjes së vazhdueshme të kërkesës për ujë, si dhe problematikat e pritshme të rezervave ujore për shkak të ndryshimeve klimatike duhet bërë një vlerësim i këtyre rezervave në krahasim me plotësimin e kërkesës për ujë, të paktën asaj aktuale.

Për këtë qëllim në tabelën 2, krahas volumit të ujit të prodhuar dhe konsumit për popullsinë e shërbyer jepen dhe burimet ujore respektive dhe kapacitetet e tyre.

Tabela 2 Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve

Sh. Rajonale Gjirokastrë	Popullsia* e Shërbyer	Uji i Prodhuar që futët në sistem	Konsumi Total i Matur dhe Aforfe	Popullsia e Regjistruar në Zonën e Shërbimit	Burimi dhe Kapaciteti i Tij	Sasia e Disponueshme e Ujit	Diferenca në Plotësimin e Kërkesës
		(në m3)	(l/ditë, banor)		(në m3)	(l/ditë, banor)	(l/ditë, banor)
Gjirokastrë	19,560	2,690,990	198.8	19,560	6,838,000	957.8	+759.0
Tepelenë	4,623	460,000	136.9	5,841	1,548,000	726.1	+589.2
Këlcyrë	1,781	856,000	263.1	3,812	27,259,000	19591.3	+19328.3
Përmet	6,858	744,760	168.5	7,158	2,170,000	830.6	+662.0
Libohove	3,542	1,148,400	235.1	3,542	389,000	300.9	+65.7
Dropull	8,023	1,045,000	243.8	8,416	4,492,000	1462.3	+1218.5
Memaliaj	2,564	236,000	152.8	4,985	1,440,000	791.4	+638.6
UK Gjirokastrë (Rajonale)	46,951	7,181,150	198.6	53,314	44,136,000	2268.1	+2069.5

* Popullsia në juridiksion u korrigjua duke u bazuar në të dhënat e INSTAT-it të publikuara në rang qarku në Janar të vitit 2023 ndërsa për popullsinë në shërbim si bazë përlllogaritje shërbeu mbulimi më shërbim i raportuar nga vetë shoqëritë UK.

Nga tabela 2 shihet se shoqëria rajonale UK Gjirokastrë ka burime të mjaftueshme ujore për plotësimin e kërkesës për ujë në zonën e saj të shërbimit. Në fokusin e shoqërisë rajonale duhet të jetë mbrojtja e burimeve nëpërmjet shfrytëzimit me efikasitet të burimeve ujore të disponueshëm, duke u bazuar në prodhimin sipas kërkesës për ujë si dhe reduktimin e humbjeve ujit në të gjitha njësitet përbërëse për të arritur dhe qëllimin final “kohëzgjatje të furnizimit më ujë më 24/7” për çdo njësi furnizimi.

II.1 UPA për Ish Shoqërinë UK Gjirokastër

Gjatë vitit 2022, ish shoqëria UK Gjirokastër ka prodhuar 2,690,990 m³ ujë, **asnjë nga burimet e shfrytëzueshme nuk është i pajisur me aparat ujëmatës** për pasojë prodhimi raportohet i vlerësuar. Numri i lidhjeve të furnizimit me ujë raportohet 13,442 lidhje me ujë nga të cilat 10,716 lidhje janë të pajisur me ujëmatës. Shërbimi i furnizimit me ujë ofrohet për 100% të popullsisë në juridiksion.

“Uji Pa të Ardhura” është në nivelin 37.79%. Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë nuk është totalisht i organizuar në zona të pavarura me matje (DMA), për rrjedhojë monitorimi i humbjeve nuk mund të bëhet i detajuar për të gjithë sistemin. Kjo gjendje vështirëson monitorimin efikas të humbjeve dhe njëkohësisht bëhet pengesë gjatë ndërtimit të strategjive për zvogëlimin e humbjeve me orientim prioriteti në DMA-të më problematike.

Në tabelën 3 paraqitet bilanci i ujit si dhe komponentët përbërës të tij për ish shoqërinë UK Gjirokastër.

Tabela 3. Bilancit i Ujit për Ish Shoqërinë Gjirokastër- Viti 2022.

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m ³)	Ndaj Ujit të Prodhuar (në%)
Volumi i ujit të prodhuar që futët në sistem	2,690,990	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	979,470	36.40%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	694,500	25.81%
Faturimi Total	1,673,970	62.21%
Konsumi i Autorizuar i Pa faturuar	6,570	0.24%
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit	50,000	1.86%
Humbjet e ujit nga lidhjeve e paligjshme në rrjetin shpërndarës	138,000	5.13%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	29,280	1.09%
Humbjet e Dukshme (Administrative)	217,280	8.07%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	235,295	8.74%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	60,000	2.23%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet dhe kapederdhjet në depot e ujit	25,867	0.96%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes	454,567	16.89%
Humbjet e ujit për shkak të riparimeve në linjat e sistemit të Ujësjesit	17,441	0.65%
Humbjet Reale (Teknike)	793,170	29.48%
Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)	1,010,450	37.55%
UJI PA TË ARDHURA	1,017,020	37.79%

Komente:

- UPA në nivelin 37.79% të prodhimit vjetor, konsiderohet në nivele akoma të pakënaqshme.
- Prodhimi vjetor i vlerësuar si dhe pasaktësia e mundshme gjatë përlllogaritjes së tij bën të pabesueshëm nivelin e Uji Pa të Ardhura. Pajisja e burimeve më ujëmatësa është emergjente për këtë njësi.
- Niveli i humbjeve reale në linjat e transmetimit (8.74%) konsiderohet mjaft i lartë. Për këtë shoqëria duhet të verifikojë nëse ekzistojnë të regjistruara në evidenca të cilat vërtetojnë çarje mjaft të shpeshta të linjave të transmisionit.
- Rreth 80% e klientëve janë të pajisur me ujëmatësa individuale, pjesa tjetër faturohet aforfe.
- Humbjet nga lidhjet e paligjshme në transmetim dhe shpërndarje në nivelin 6.99% të prodhimit vjetor konsiderohen të larta, shoqëria nëpërmjet task forcës duhet të angazhohet për eliminimin e tyre sa më shpejt të jetë e mundur.

Rekomandime:

- Për eliminimin e lidhjeve të paligjshme, Njësia Gjirokastër duhet të hartojë plan veprimi për të përcaktuar sa më saktësisht bazën e klientëve, që krahas verifikimeve në terren (task forcë) të krahasohet edhe me bazën e klientëve të OSHEE-së, si edhe me verifikime në vend për anashkalim të ujëmatësit me lidhje dytësore.
- Të thellohet në analizën për të përcaktuar se ku ekziston saktësisht problematika më ujin e faturuar aforfe i cili rezultoi në nivele mjaft të larta (412.2 l/banorë në ditë), si kontroll i punës së lexuesve të matësive, për të verifikuar sa klientë faturohen aforfe dhe se sa është numri i banorëve për çdo lidhje bazuar në certifikatën familjare të vitit aktual.
- Të angazhohet për zgjidhjen e problemit që uji i prodhuar të jetë i matur dhe jo i vlerësuar duke planifikuar fondet përkatëse për prokurimin dhe instalimin e matësive në burim nga qeveria qendrore ose më fondet e veta.
- Shoqëria të konsiderojë si prioritet ndarjen e rrjeteve të shpërndarjes në DMA për të gjithë zonën e shërbimit të cilat mundësojnë monitorimin më të mirë të humbjeve, për të diagnostikuar ku janë problemet më të mëdha me humbjet, në bazë të të cilave do të hartohen planet e masave për zvogëlimin e tyre.

II.2 UPA për Ish Shoqërinë UK Tepelenë

Shërbimi i furnizimit me ujë në Njësinë Tepelenë ofrohet për 79.1% të popullsisë në juridiksion. Prodhimi vjetor i raportuar është 460,000 m³ që **vetëm 34 % e tij rezulton me matje**.

Numri i lidhjeve me ujin raportohet 2900 lidhje ku 1961 prej tyre janë të pajisur me ujëmatës ndërsa pjesa tjetër faturohet aforfe.

Faturimi total rezulton në nivelin 66.63% të prodhimit.

“Uji Pa të Ardhura” është në nivelin 33.37%. Monitorimi i humbjeve në rrjetin shpërndarës nuk bëhet në bazë të DMA-ve për të gjithë zonën e shërbimit.

Në Tabelën 4 paraqiten komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për ish shoqërinë UK Tepelenë.

Tabela 4. Bilanci i Ujit për Ish Shoqërinë UK Tepelenë – Viti 2022

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m ³)	Ndaj Ujit të Prodhuar (në%)
Volumi i ujit të prodhuar që futët në sistem	460,000	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	234,500	50.98%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	72,000	15.65%
Faturimi total	306,500	66.63%
Konsumi i autorizuar i pa faturuar	4,000	0.87%
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit	7,000	1.52%
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në rrjetin shpërndarës	10,471	2.28%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	24,250	5.27%
Humbjet e dukshme (administrative)	41,721	9.07%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	21,560	4.69%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	826	0.18%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet e derdhjet në depot e ujit	7,521	1.64%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes	74,258	16.14%
Humbjet e ujit nga riparimet në linjat e sistemit të Ujësjetës	3,614	0.79%
Humbjet Reale të ujit (teknike)	107,779	23.43%
Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)	149,500	32.50%
UJI PA TË ARDHURA	153,500	33.37%

Komente:

- UPA në nivelin 33.37% të prodhimit vjetor, ndonëse gjendet shumë pranë performancës së mirë, nuk është shumë i besueshëm sepse prodhimi vjetor me matje është në nivele të pakënaqshme, si dhe nuk faturohen me matje 100% të klientëve në zonën e shërbimit.
- Humbjet administrative në nivelin 9.07% të prodhimit shkaktohen kryesisht nga lidhjet e paligjshme në rrjetet e transmetimit (1.52%), shpërndarje (2.28%) dhe nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim (5.27%).
- Humbjet teknike në nivelin 23.43% rezultojnë kryesisht nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës (16.14%) dhe atë të transmetimit (4.69%).

Rekomandime:

- *Duke patur parasysh që burimet e shfrytëzueshëm nuk janë të gjithë të pajisur me ujëmatës, nevoja për investime në ujëmatës në prodhim është e domosdoshme dhe imediate. Shoqëria duhet të marrë masa urgjentë për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e tyre, në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa më real.*
- *Shoqëria të shoh si prioritet monitorimin e humbjeve nëpërmjet ndarjes së rrjeteve të shpërndarjes në DMA, për të diagnostikuar ku janë problemet më të mëdha me humbjet, në bazë të të cilave do të hartohen planet e veprimeve për zvogëlimin e tyre.*
- *Të thellohet në analizën për të përcaktuar se ku ekziston saktësisht problematika me ujin e faturuar aforfe i cili rezultoi nën normën e vendosur (150 l/banorë në ditë), si kontroll i punës së lexuesve të matësive, për të verifikuar sa klientë faturohen aforfe dhe se sa është numri i banorëve për çdo lidhje bazuar në certifikatën familjare të vitit aktual.*

II.3 UPA për Ish Shoqërinë UK Këlcyrë

Shërbimi i furnizimit me ujë në Njësinë Administrative Këlcyrë ofrohet për 46,7% të popullsisë në juridiksion. Prodhimi vjetor në sasinë 856,000 m³ ujë **rezulton me matje në burim në nivelin 20.3%** ndërsa pjesa tjetër vlerësohet.

Nga raportimi i të dhënave, faturimi rezulton 23.60% e prodhimit, ndërsa "Uji Pa të Ardhura" në nivelin 76.40%. Ish shoqëria UK Këlcyrë ka në administrim 1,771 lidhje me ujin nga të cilat 1,685 lidhje faturohen me matje dhe pjesa tjetër aforfe. Monitorimi i humbjeve në rrjetin shpërndarës nuk bëhet në bazë të DMA-ve, prezenca e lidhjeve të paligjshme rezulton në nivele të larta (32.4%).

Shoqëria shpesh herë ka paraqitur vështirësi në përgatitjen e bilancit të ujit, për këtë vit ajo nuk ka dorëzuar bilancin dhe të dhënat e paraqitura në tabelën 5 janë marrë në Njësinë e Monitorimit të ERRU-së dhe janë përpunuar nga Sektori Teknik, duke u bazuar në të dhënat e vitit paraardhës.

Në Tabelën 5 paraqiten komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për ish shoqërinë UK Këlcyrë mbi të cilat bazohet analiza e humbjeve të ujit.

Tabela 5. Bilanci i Ujit për Ish Shoqërinë UK Këlcyrë – Viti 2022

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m3)	Ndaj Ujit të Prodhuar (në%)
Volumi i ujit të prodhuar që futët në sistem	856,000	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	194,000	22.66%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	8,000	0.93%
Faturimi Total	202,000	23.60%
Konsumi i Autorizuar i Pa Faturuar	3,500	0.41%
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit	77,500	9.05%
Humbjet e ujit nga lidhjeve e paligjshme në rrjetin shpërndarës	200,000	23.36%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	81,000	9.46%
Humbjet e Dukshme (Administrative)	358,500	41.88%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	60,000	7.01%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	25,000	2.92%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet dhe kapërderdhjet në depot e ujit	22,000	2.57%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes	180,000	21.03%
Humbjet e ujit për shkak të riparimeve në linjat e sistemit të Ujësjetës	5,000	0.58%
Humbjet Reale (Teknike)	292,000	34.11%
Humbjet Totale (Reale dhe të Dukshme)	650,500	75.99%
UJI PA TË ARDHURA	654,000	76.40%

Komente:

- UPA rezulton në nivelin **76.40%** të prodhimit vjetor dhe konsiderohet në nivele të larta e të papranueshme.
- Vlerësimi dhe analiza e humbjeve nuk kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe në zona të ndara më matje (DMA), formati i bilancit të ujit shpesh herë plotësohet nga stafi i shoqërisë me mjaft vështirësi. Shihet si domosdoshmëri nevoja për trajnim të stafit mbi humbjet e ujit dhe monitorimin e tyre.
- Pasaktësia e mundshme në llogaritjen e sasisë së ujit të prodhuar, vështirësitë në hartimin e bilancit të ujit, mungesa e DMA-ve etj, cenon mjaft besueshmërinë e vlerës absolute të volumit të ujit të prodhuar dhe njëkohësisht të treguesit UPA.
- Humbjet teknike në nivelin 34.11% të prodhimit vjetor konsiderohen mjaft të larta, ato humbasin 21.03% në rrjetin shpërndarës dhe 7.01% në linjën e transmetimit.
- Humbjet administrative (41.88%) raportohen në nivele të larta dhe të pa pranueshme, ato shkaktohen nga lidhjet e paligjshme në transmetim në nivelin 9.05% e prodhimit ndërsa në shpërndarje 23.36% e tij, gjithashtu në nivele të larta (9.46%) konsiderohen dhe humbjet gjatë vlerësimit të volumeve të prodhuara, të faturuara, nën faturime etj.
- Konsumi total faturohet më matje në nivelin 96% ndërsa 95% e konsumatorëve janë të pajisur më aparate ujëmatës individuale.

Rekomandime:

- Duke patur parasysh që prodhimi matet në nivele të pakënaqshme (20.3%), nevoja për investime në ujëmatës në prodhim është e domosdoshme dhe imediate. Shoqëria duhet të marrë masa urgjente për gjetjen e fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e matësve në prodhim, në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa më real.

- Në lidhje me përqindjen e lartë të lidhjeve të paligjshme që ajo raporton, Njësia Këlcyrë duhet të ndërmarrë plan veprimi për të përcaktuar sa më saktësisht bazën e klientëve, që krahas verifikimeve në terren (task-forcë) të krahasohet edhe me bazën e klientëve të OSHEE-së, si edhe me verifikime në vend për anashkalim të ujëmatësit me lidhje dytësorë dhe të hartojë planet e veprimit për eliminim e tyre.
- Duke patur parasysh mangësitë dhe vështirësitë në raportimet e vlerave të Bilancit të ujit që ka demonstruar staf i shoqërisë, është i domosdoshëm trajnimi i stafit si dhe caktimi i një personi përgjegjës për monitorimin e humbjeve, saktësimin e të dhënave si dhe hartimin e bilancit të ujit për gjatë gjithë muajve të vitit.
- Shoqëria të shoh si prioritet ndarjen e rrjeteve të shpërndarjes në DMA të cilat mundësojnë monitorimin më të mirë të humbjeve, për të diagnostikuar ku janë problemet më të mëdha me humbjet, në bazë të të cilave do të hartohen planet e veprimeve për zvogëlimin e tyre.

II.4 UPA për Ish Shoqërinë UK Përmet

Njësia Administrative Përmet ofron shërbimin e furnizimit me ujë për rreth 98.5% të popullsisë në juridiksion. Prodhimi vjetor raportohet në sasinë 744,760 m3 ujë dhe **100% i vlerësuar (pa matje)** pasi asnjë nga burimet nuk është i pajisur me aparat ujëmatës.

Treguesi i UPA rezulton në nivelin 33.51%. Konsumi i Autorizuar i Faturuar raportohet në nivelin 66.49% ndërsa Konsumi i Autorizuar i pa Faturuar në nivelin 2.12% e prodhimit ndërkohë që Shoqëria duhet të konsumojë për nevojat e veta rreth 1% të ujit të prodhuar.

Numri total i lidhjeve për shërbimin e furnizimit me ujë raportohet 4,892 lidhje, nga të cilat rreth 91% e tyre faturohet me matje ndërsa pjesa tjetër aforfe. Lidhjet e paligjshme raportohen të pranishme si në rrjetin e transmetimit (2.30%) dhe atë të shpërndarjes (3.31%).

Në Tabelën 6 paraqitet Bilanci i Ujit dhe komponentët përbërës të tij për ish shoqërinë UK Përmet.

Tabela 6. Bilanci i Ujit për Ish Shoqërinë UK Përmet – Viti 2022

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m3)	Ndaj Ujit të Prodhuar (në%)
Volumi i ujit të prodhuar që futët në sistem	744,760	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	469,260	63.01%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	25,913	3.48%
Faturimi Total	495,173	66.49%
Konsumi i Autorizuar i Pa faturuar	15,780	2.12%
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit	17,100	2.30%
Humbjet e ujit nga lidhjeve e paligjshme në rrjetin shpërndarës	24,680	3.31%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	10,580	1.42%
Humbjet e Dukshme (Administrative)	52,360	7.03%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	41,747	5.61%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	8,660	1.16%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet dhe kapërderdhjet në depot e ujit	9,300	1.25%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes	117,900	15.83%
Humbjet e ujit nga riparimet në linjat e sistemit të Ujësjetës	3,840	0.52%
Humbjet Reale (Teknike)	181,447	24.36%
Humbjet Totale (Reale dhe të Dukshme)	233,807	31.39%
UJI PA TË ARDHURA	249,587	33.51%

Komente :

- UPA (33.51%) ndonëse qëndron pranë kufirit të mirë të performancës ende ka mundësi për përmirësim të mëtejshëm nëpërmjet eliminimit të lidhjeve të paligjshme në rrjet. Prodhimi i ujit në burim i vlerësuar në nivelin 100% e bën të pabesueshëm këtë tregues, shoqëria duhet të jetë e kujdesshme gjatë vlerësimit të prodhimit për të hartuar një bilanc uji të saktë e të besueshëm, deri në finalizimin e të gjitha burimeve më ujëmatës.
- Faturimi raportohet i matur në nivelin 94.8%, ndërsa 91% e konsumatorëve familjare janë të pajisur me matës.
- Vlerësimi dhe analiza e humbjeve kryhet pjesërisht në zona të ndara me matje (DMA).
- Humbjet e dukshme (7.03%) raportohen nga lidhjet e paligjshme në transmetim (2.30%), në shpërndarje (3.31%) dhe nga pasaktësia në matje (1.42%).
- Trajnimi i stafit mbi humbjet e ujit dhe monitorimin e tyre është i nevojshëm pasi janë konstatuar vështirësi për hartimin e bilancit të ujit.

Rekomandime:

- Duke patur parasysh që asnjë burim furnizimi me ujë nuk është i pajisur me ujëmatës nevoja për investime në ujëmatës në prodhim është e domosdoshme dhe imediate, prandaj shoqëria duhet të marrë masa urgjentë për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e tyre në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa më real.
- Shoqëria duhet të gjejë fonde për të rritur përqindjen e konsumatorëve familjare me matës që ky tregues të jetë sa më afër nivelit 100%, për të mundësuar minimizimin e humbjeve të dukshme nga lidhjet e paligjshme. Ndonëse këto humbje raportohen në nivele mjaft të ulta, ka arsye për të qenë të pabesueshëm.
- Duke patur parasysh mangësitë dhe vështirësitë në raportimet e vlerave të Bilancit të ujit që ka demonstruar stafi i shoqërisë, është i domosdoshëm trajnimi i stafit si dhe caktimi i një personi përgjegjës për monitorimin e humbjeve, saktësimin e të dhënave si dhe hartimin e bilancit të ujit për gjatë gjithë muajve të vitit.
- Shoqëria të shohë si prioritet ndarjen e rrjeteve të shpërndarjes në DMA të cilat mundësojnë monitorimin më të mirë të humbjeve, diagnostikimin dhe hartimin e planeve të masave për zvogëlimin e tyre.
- Të thellohet në analizën për të përcaktuar se ku ekziston saktësisht problematika me ujin e faturuar aforfe i cili rezultoi nën normën e vendosur (150 l/banorë në ditë), si kontroll i punës së lexuesve të matësve, për të verifikuar sa klientë faturohen aforfe dhe se sa është numri i banorëve për çdo lidhje, bazuar në certifikatën familjare të vitit aktual.

II.5 UPA për Ish Shoqërinë UK Libohovë

Njësia Libohovë ka prodhuar 1,148,400 m³ ujë, **prodhimi raportohet i vlerësuar në nivelin 100%** pasi asnjë burim i shfrytëzueshëm nuk është i pajisur me matës.

Numri i lidhjeve për shërbimin e furnizimit me ujë është 1544 lidhje prej të cilave vetëm 28 lidhje janë të pajisur me aparat ujëmatës.

Shërbimi i furnizimit me ujë ofrohet për 100% të popullsisë në juridiksion.

“UPA”, 72.58% e prodhimit, rezulton në nivel të pakënaqshëm dhe të pa tolerueshme që duhet të përmirësohet me urgjencë.

Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë nuk është i organizuar në zona të pavarura me matje (DMA) për rrjedhje monitorimi i humbjeve nuk mund të bëhet i detajuar sipas DMA-ve, por në tërësi për të gjithë sistemin. Kjo gjëndje vështirëson monitorimin efikas të humbjeve dhe njëkohësisht bëhet pengesë gjatë ndërtimit të strategjive për zvogëlimin e humbjeve me orientim prioriteti në DMA-të më problematike.

Për vitin 2022, Njësia Libohovë nuk e dorëzoi bilancin pranë ERRU-së. Të dhënat e paraqitura në tabelën 7 janë marrë në Njësinë e Monitorimit të ERRU-së dhe janë përpunuar nga Sektori Teknik, duke u bazuar në të dhënat e vitit paraardhës. Nga monitorimi në vite i Bilancit të Ujit konstatohet se nevoja për trajnimin e stafit “mbi humbjet e ujit dhe menaxhimin e tyre” është e domosdoshme.

Në tabelën 7 paraqitet bilanci i ujit si dhe komponentët përbërës të tij për ish shoqërinë UK Libohovë.

Tabela 7. Bilanci i Ujit për Ish Shoqërinë UK Libohovë - Viti 2022.

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m3)	Ndaj Ujit të Prodhuar (në%)
Volumi i ujit të prodhuar që futët në sistem	1,148,400	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	7,000	0.61%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	307,907	26.81%
Faturimi Total	314,907	27.42%
Konsumi i Autorizuar i Pa faturuar	1,000	0.09%
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit	152,000	13.24%
Humbjet e ujit nga lidhjeve e paligjshme në rrjetin shpërndarës	150,000	13.06%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	215,000	18.72%
Humbjet e Dukshme (Administrative)	517,000	45.02%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	60,000	5.22%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	25,000	2.18%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet dhe kapërderdhjet në depot e ujit	25,000	2.18%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes	200,000	17.42%
Humbjet e ujit nga riparimet në linjat e sistemit të Ujësijellësit	5,493	0.48%
Humbjet Reale (Teknike)	315,493	27.47%
Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)	832,493	72.49%
UJI PA TË ARDHURA	833,493	72.58%

Komente:

- UPA në nivelin 72.58% të prodhimit vjetor, konsiderohet në nivele mjaft të larta dhe i papranueshëm.
- Volumi i ujit të prodhuar raportohet i vlerësuar në nivelin 100%. Përqindja mjaft e ulët e prodhimit të matur si dhe pasaktësia e mundshme gjatë përlllogaritjes të sasisë së ujit të prodhuar më vlerësim mund të jetë shkak kryesor i diferencës mjaft të madhe ndërmjet volumit të ujit të prodhuar ndaj atij të faturuar.
- Niveli i lartë i humbjeve administrative (45.02%) shkaktohet kryesisht nga lidhjet e paligjshme në rrjetin e transmetimit (13.24%) dhe të shpërndarjes (13.06%), gjithashtu mjaft të larta (18.72%) raportohen dhe humbjet nga pasaktësia gjatë vlerësimit të volumeve, nën faturime etj.
- Vetëm 1,8 % e klientëve janë të pajisur me ujëmatës, pjesa tjetër faturohen aforfe.

Rekomandime:

- Në lidhje me përqindjen e lartë të mundshme të lidhjeve të paligjshme, Njësia duhet të ndërmarrë plan veprimi për të përcaktuar sa më saktësisht bazën e klientëve, që krahas verifikimeve në terren (task forcë) të krahasohet edhe me bazën e klientëve të OSHEE-së, si edhe me verifikime në vend për anashkalim të ujëmatësimit me lidhje dytësore.
- Të thellohet në analizën për të përcaktuar se ku ekziston saktësisht problematika me ujin e faturuar aforfe (235 l/ditë për banorë), si kontrolli i punës së lexuesve të matësive, për të verifikuar sa klientë faturohen aforfe dhe se sa është numri i banorëve për çdo lidhje, bazuar në certifikatën familjare të vitit aktual.
- Ti kushtohet kujdes dhe rëndësi e veçantë volumit të ujit të prodhuar që përcaktohet me vlerësim, për t'ju afuar sa më shumë realitetit deri sa të mundësohet prodhimi i matur në nivelin 100%. Shoqëria të angazhohet për sigurimin e fondeve, prokurimin dhe instalimin e ujëmatësive në burim.
- Shoqëria të shoh si prioritet ndarjen e rrjeteve të shpërndarjes në DMA të cilat mundësojnë monitorimin më të mire të humbjeve, për të diagnostikuar ku janë problemet më të mëdha me humbjet, në bazë të të cilave do të hartohen planet e masave për zvogëlimin e tyre.

II.6 UPA për Ish Shoqërinë UK Dropull

Shërbimi i furnizimit me ujë në Njësinë Administrative Dropull ofrohet për 95.3% të popullsisë në juridiksion. Prodhimi vjetor i vlerësuar raportohet 1,045,000 m³ ujë, **asnjë nga burimet e shfrytëzueshme nuk është i pajisur me aparat ujëmatës.**

Numri i lidhjeve me ujin raportohet 4450 lidhje ku asnjëra prej tyre nuk është e pajisur me ujëmatës. Faturimi total rezulton në nivelin 72.84% të prodhimit ndërsa “Uji Pa të Ardhura” në nivelin 27.16%. Monitorimi i humbjeve në rrjetin shpërndarës nuk behet në baze të DMA-ve.

Mungesa e matësve në prodhim dhe konsumatorë e bën të pabesueshëm vlerësimin e treguesit UPA. Investimi në ujëmatës për pikat e prodhimit dhe për të gjitha kategoritë e konsumatorëve është i domosdoshëm për hartimin real të bilancit dhe të vlerësimit të saktë të treguesit të UPA, si dhe përcaktimin e problematikave mbi humbjet dhe hartimin e planeve të veprimit për reduktimin e tyre.

Në Tabelën 8 paraqiten komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për ish shoqërinë UK Dropull.

Tabela 8. Bilanci i Ujit për Ish Shoqërinë UK Dropull – Viti 2022

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m ³)	Ndaj Ujit të Prodhuar (në%)
Volumi i ujit të prodhuar që futët në sistem	1,045,000	100.00%
Volumi i ujit të prodhuar që futët në sistem	739,200	70.74%
Volumi i ujit të prodhuar që futët në sistem	22,000	2.11%
Faturimi total	761,200	72.84%
Konsumi i autorizuar i pa faturuar	2,000	0.19%
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit	5,000	0.48%
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në rrjetin shpërndarës	11,000	1.05%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	16,000	1.53%
Humbjet e dukshme (administrative)	32,000	3.06%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	63,000	6.03%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	10,000	0.96%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet e derdhjet në depot e ujit	11,000	1.05%

Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes	164,800	15.77%
Humbjet e ujit nga riparimet në linjat e sistemit të Ujësjellësit	1,000	0.10%
Humbjet Reale të ujit (teknike)	249,800	23.90%
Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)	281,800	26.97%
UJI PA TË ARDHURA	283,800	27.16%

Komente :

- UPA raportohet në nivele të kënaqshme dhe përben 27.16% të prodhimit vjetor.
- Pasaktësia e mundshme gjatë përlllogaritjes të sasisë së ujit të prodhuar me vlerësim (për 100% i vlerësuar) si dhe faturimi aforfe për të gjithë kategoritë e klientëve në fakt e bën të pabesueshëm treguesin e UPA.
- Humbjet administrative (3.06%) shkaktohen kryesisht nga lidhjet e paligjshme në rrjetet e transmetimit (0.48%), shpërndarje (1.05%) dhe nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim (1.53%).
- Humbjet teknike në nivelin 23.90%, përkatësisht në rrjetin shpërndarës (15.77%) dhe në linjat e transmetimit (6.03%), konsiderohen në kufijtë e niveleve të pranueshme.

Rekomandime:

- *Duke patur parasysh që asnjë burim i shfrytëzueshëm nuk është i pajisur me ujëmatës, nevoja për investime në ujëmatës në prodhim është e domosdoshme dhe imediate. Shoqëria duhet të marrë masa urgjentë për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e tyre në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa më real.*
- *Në lidhje me ekzistencën e lidhjeve të paligjshme, Njësia duhet të ndërmarrë plan veprimi për të përcaktuar sa më saktësisht bazën e klientëve, që krahas verifikimeve në terren (taks-forcë) të krahasohet edhe me bazën e klientëve të OSHEE-së, si edhe me verifikime në vend për anashkalim të ujëmatësit me lidhje dytësorë.*
- *Shoqëria të shoh si prioritet ndarjen e rrjeteve të shpërndarjes në DMA të cilat mundësojnë monitorimin më të mirë të humbjeve, diagnostifikimin dhe hartimin e planeve të veprimit për zvogëlimin e tyre.*
- *Të thellohet në analizën për të përcaktuar se ku ekziston saktësisht problematika me ujin e faturuar aforfe (243.8 l/ditë për banorë), si kontrolli i punës së lexuesve të matësive, për të verifikuar sa klientë faturohen aforfe dhe se sa është numri i banorëve për çdo lidhje, bazuar në certifikatën familjare të vitit aktual.*

II.7 UPA për Ish Shoqërinë UK Memaliaj

Shërbimi i furnizimit me ujë në Njësinë Administrative Memaliaj ofrohet për 51.4% të popullsisë në juridiksion. **Prodhimi vjetor i ujit raportohet 100%** i vlerësuar dhe në sasinë 236,000 m³ ujë, sepse asnjë nga burimet e shfrytëzueshme nuk është i pajisur me aparat ujëmatës.

Nga raportimi i të dhënave, faturimi rezulton 65.42% e prodhimit, ndërsa **“Uji Pa të Ardhura” në nivelin 34.58%.**

Ish shoqëria UK Memaliaj ka në administrim 2,024 lidhje me ujë nga të cilat 1,507 lidhje apo 74,4% e tyre faturohen me matje dhe pjesa tjetër aforfe.

Monitorimi i humbjeve në rrjetin shpërndarës nuk bëhet në bazë të DMA-ve.

Në Tabelën 9 paraqiten komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për ish shoqërinë UK Memaliaj.

Tabela 9. Bilanci i Ujit për Ish Shoqërinë UK Memaliaj – Viti 2022

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m ³)	Ndaj Ujit të Prodhuar (në%)
Volumi i ujit të prodhuar që futët në sistem	236,000	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	131,400	55.68%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	23,000	9.75%
Faturimi Total	154,400	65.42%
Konsumi i Autorizuar i Pa Faturuar	1,000	0.42%
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit	2,000	0.85%
Humbjet e ujit nga lidhjeve e paligjshme në rrjetin shpërndarës	9,300	3.94%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	11,500	4.87%
Humbjet e Dukshme (Administrative)	22,800	9.66%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	13,100	5.55%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	3,000	1.27%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet dhe kapërderdhjet në depot e ujit	1,600	0.68%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes	37,000	15.68%
Humbjet e ujit nga riparimet në linjat e sistemit të Ujësjesit	3,100	1.31%
Humbjet Reale (Teknike)	57,800	24.49%
Humbjet Totale (Reale dhe të Dukshme)	80,600	34.15%
Volumi i ujit të prodhuar që futët në sistem	81,600	34.58%

Komente:

- UPA rezulton në nivelin 34.58% të prodhimit vjetor. Gjithsesi ky tregues duhet justifikuar nga një verifikim më i saktë i të dhënave në terren, sidomos praninë e lidhjeve të paligjshme.
- Humbjet teknike në nivelin 24.49% të prodhimit vjetor, ku 15.68% i përkasin rrjetit shpërndarës dhe 5.55% linjave të transmetimit, janë në nivele të pranueshme.
- Konsumi total faturohet me matje në nivelin 85% ndërkohë 74,4% e konsumatorëve janë të pajisur me matësa individuale duke përfaqësuar një nivel jo shumë të dëshirueshëm të matjes.

Rekomandime:

- Duke patur parasysh që asnjë burim furnizimi me ujë nuk është i pajisur me ujëmatës nevoja për investime në ujëmatësa në prodhim është e domosdoshme dhe imediate, shoqëria duhet të marrë masa urgjentë për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e tyre, në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa më real.
- Shoqëria duhet të gjeje fonde për të rritur përqindjen e konsumatorëve familjare me matës që ky tregues të jetë sa më afër nivelit 100%, që të bëjë të mundur minimizimin e humbjeve të dukshme nga lidhjet e paligjshme.
- Duke patur parasysh mangësitë dhe vështirësitë në raportimet e vlerave të Bilancit të ujit që ka demonstruar stafi i shoqërisë, është i domosdoshëm trajnimi i stafit si dhe caktimi i një personi

përgjegjës për monitorimin e humbjeve, saktësimin e të dhënave si dhe hartimin e bilancit të ujit për gjatë gjithë muajve të vitit.

- Shoqëria të shoh si prioritet ndarjen e rrjeteve të shpërndarjes në DMA të cilat mundësojnë monitorimin më të mirë të humbjeve, për të diagnostikuar ku janë problemet më të mëdha me humbjet, në bazë të të cilave do të hartohen planet e masave për zvogëlimin e tyre.
- Të thellohet në analizën për të përcaktuar se ku ekziston saktësisht problematika me faturimin aforfe (88.5 l/ditë për banorë) nën normën 150 l/ditë për banorë, si kontroll i punës së lexuesve të matësve, për të verifikuar sa klientë faturohen aforfe dhe se sa është numri i banorëve për çdo lidhje, bazuar në certifikatën familjare të vitit aktual.

III Përmbledhëse e UPA për Shoqërinë Rajonale UK Gjirokastrë

Shoqëria Rajonale UK Gjirokastrë, u krijua nga bashkimi i ish shoqërive UK Gjirokastrë, Tepelenë, Këlcyrë, Përmet, Libohovë, Dropull dhe UK Memaliaj.

Mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë realizohet vetëm për 46,951 banorë ose 88% të popullsisë totale. Numri i lidhjeve për shërbimin e furnizimit me ujë raportohet 31,123 lidhje, nga të cilat 20,349 lidhje janë të pajisur me aparate ujëmatës.

Prodhimi vjetor 7,181,150 m³ rezulton i matur në nivelin 5%, nevoja e aparateve ujëmatës në pikat prodhuese është imediate pothuajse për të gjitha burimet e shfrytëzueshme.

Uji Pa të Ardhura rezultoi në nivelin 45.58% të ujit që hyn në sistem, shoqëria faturon vetëm 3,908,150 m³ ujë ose 54.42% të prodhimit.

Tabela 10 jep komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për vitin 2022, për Sh. Rajonale UK Gjirokastrë.

Tabela 10. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Gjirokastrë – Viti 2022

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m ³)	Ndaj Ujit të Prodhuar (në%)
Volumi i ujit të prodhuar që futët në sistem	7,181,150	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	2,754,830	38.36%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	1,153,320	16.06%
Faturimi Total	3,908,150	54.42%
Konsumi i Autorizuar i Pa faturuar	33,850	0.47%
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit	310,600	4.33%
Humbjet e ujit nga lidhjeve e paligjshme në rrjetin shpërndarës	543,451	7.57%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	387,610	5.40%
Humbjet e Dukshme (Administrative)	1,241,661	17.29%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	494,702	6.89%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	132,486	1.84%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet dhe kapërderdhjet në depot e ujit	102,288	1.42%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes	1,228,525	17.11%
Humbjet e ujit nga riparimet në linjat e sistemit të Ujësjellësit	39,488	0.55%
Humbjet Reale (Teknike)	1,997,489	27.82%
Humbjet Totale (Reale dhe të Dukshme)	3,239,150	45.11%
UJI PA TË ARDHURA	3,273,000	45.58%

Komente :

- Treguesi UPA në nivelin 45.58% të prodhimit vjetor, megjithëse nën mesataren e sektorit për të gjithë vendin konsiderohet i lartë dhe duhet përmirësuar.
- Niveli i matjes për faktorin “Uji i Prodhuar”, në nivelin 5% është i papranueshëm, gjë e cila bën të pa besueshme të gjitha vlerat absolute të vëllimeve të ujit që janë komponentë të bilancit të ujit.
- Humbjet nga lidhjet e paligjshme në rrjetin e shpërndarjes (7.57%) dhe të transmetimit (4.33%) gjithashtu konsiderohen të pa besueshme.
- Humbjet teknike nga rrjedhjet në linjat e transmetimit (6,89%) konsiderohen mjaft të larta për të cilat duhen dhënë argumente të mëtejshme për justifikimin e tyre.
- Konsumatorët familjare me matje përbëjnë rreth 62% të numrit total të konsumatorëve familjare, që për një menaxhim korrekt të Kërkesës për Ujë kërkohet të jetë sa më afër nivelit 100% të matjes.
- Vlerësimi dhe analiza e humbjeve nuk kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe në zona të ndara me matje (DMA) në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë.
- Në përgjithësi hasen mjaft vështirësi për monitorimin e humbjeve dhe hartimin e bilancit të ujit për të gjitha njësitë që përbëjnë Shoqërinë Rajonale UK Gjirokastër.

Rekomandime:

- *Duke patur parasysh që pjesa më e madhe e burimeve të furnizimit me ujë nuk janë të pajisur me ujëmatës, nevoja për investime në ujëmatës në prodhim është e domosdoshme dhe imediate. Shoqëria duhet të marrë masa urgjentë për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e tyre në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa më real që do të përcaktojë më pas dhe nivelin real të UPA.*
- *Të bëhen përpjekje për sigurimin e fondeve për të projektuar dhe zbatuar sisteme DMA në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë që mundëson një monitorim, diagnostikim dhe marrjen e masave për uljen e humbjeve në sistemet e furnizimit me ujë, si dhe hartimin e një bilanci korrekt të ujit.*
- *Të trajnojnë vazhdimisht stafin teknik në programet kombëtare të humbjeve të ujit të organizuara nga SHUKALB dhe më gjerë, si dhe të caktojë një person përgjegjës për monitorimin, përpunimin dhe saktësimin e të dhënave të raportuara, për hartimin e bilancit të ujit për çdo DMA dhe për të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë rajonale.*
- *Shoqëria duhet të gjejë fonde për të rritur përqindjen e konsumatorëve familjarë me matës që ky tregues të jetë sa më afër nivelit 100%, për të mundësuar një menaxhim racional të kërkesës për ujë, si dhe minimizimin e humbjeve të dukshme.*
- *Hartimi i një plan veprimi me prioritet instalimin e matësve në shtëpitë private dhe kryesisht në zonat rurale.*
- *Në lidhje me përqindjen e lartë të mundshme të lidhjeve të paligjshme, shoqëria duhet të ndërmarrë plan veprimi për të përcaktuar sa më saktë bazën e klientëve bazuar edhe në bazën e klientëve të OSHEE-së.*
- *Të ngrihet një Task Forcë për veprim në terren me verifikime për anashkalim të ujëmatësit me lidhje detyësore apo klientë të paregjistruar me kontratë me shoqërinë, kontrollin e punës së lexuesve të matësve etj.*

- *Të krijojë dhe të mirëmbajë të gjitha sistemet e informacionit, për të patur raportim të saktë dhe të besueshëm të të dhënave të kërkuara, në lidhje me bilancin e ujit dhe çdo informacioni tjetër që mund të kërkoet.*
- *Të planifikojë investime në ujëmatës për të gjithë kategoritë e konsumatorëve, për të patur konsum të matur për çdo lidhje uji që faturohet.*
- *Për korrigjimin e normave të faturimit me matje, shoqëria duhet të angazhohet në gjetjen e lidhjeve dyfishe. Për çdo lidhje pa matës, në pamundësi për vendosjen e matësit, nëpërmjet faturuesve duhet të verifikohet numri i banorëve (certifikatë familjare aktuale) për çdo lidhje dhe më pas të faturohen sipas VKM nr.102, datë 16.03.1992.*
- *Problematika në disa raste nuk është e njëjtë për çdo njësi. Për këtë duhet ti referohet problematikës në bilancin përkatës të çdo Njësie të veçantë.*
- *Të rrisë bashkëpunimin me ERRU-në për të tejkaluar vështirësitë në hartimin e bilancit të ujit dhe të dorëzojë atë në kohë pranë ERRU-së. Bilanci i ujit duhet të dorëzohet çdo 6 muaj, vërtetësia dhe saktësia e të dhënave të bilancit do të vlerësohet nga ERRU si penalitet ose bonus për shoqërinë raportuese.*